Eftali Qirjaqi
*AUDITUES LIGJOR*
Liçensë Nr. 11 Datë 11.01.2000,NIPT K46526078J,
Lagje "Qemal Stafa", Rr. "Studenti", Shkodër
Mobile:+355692069434, +355692079434
Email : eliqirjaqi@yahoo.com

**Drejtuar ;**

**Z. Rivelino Çuno, Kryetari i Partisë për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë**

**Adresa e Partisë; Rruga "Komuna e Parisit", Pallatet Hawai, kati i 3, Tiranë**

***Lënda: Kërkim informacioni***

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve me vendimin nr.112, datë 27.03.2019 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të liçensuar, të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2018" më ka emëruar auditues ligjor, i cili do të auditojë fondet e përfituara dhe të shpenzuara të Partisë për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë, për periudhën 01 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018.

Për të mundësuar realizimin e misionit të ngarkuar nga ligji sipas nenit 5 përcaktuar në kontratën e shërbimit lidhur me datë 18.05.2019 me nr. prot 889/1 , mes Ekspertes Kontabël (Auditues Ligjor) znj. Eftali Qirjaqi si ofruesi i shërbimit dhe KQZ përfaqësuar nga z. Klement Zguri Kryetar i KQZ, si porositësi i shërbimit,

Ju lutemi të na vini në dispozicion të ekspertit të gjithë dokumentave financiarë të nevojshme:

- Pasqyrat financiare vjetore me të gjithë dokumentacionin shoqërues me firme dhe vule origjinal.
- Deklaratën vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve mbi fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjekti zgjedhor për periudhën financiare 2018
- Llogarite Bankare me te cilat keni pasë veprimtari financiare, të skanuara 01 janar 2018 deri 31/12/2018
- Gjëndjen e mjeteve monetare në arkën e Partisëpër Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë më datën 01/01/2018 dhe datën 31/12/2018
- Dokumentacionin financiar (shkresen) ne rast se keni pasë nga Kqz per kalimin e fondeve nga Ministria e Financave per llogari te Partisë për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë gjate vitit financiar 2018 pra, justifikimin shkresor te çdo hyrje ne llogarine bankare nga Ministria e Financave per vitin 2018. Ne rast kthimi te fondeve te marra paraprakisht nga Partia për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë, per llogari te KQZ-se , justifikimin shkresor dhe urdher xhirimin per kthimin e shumes.
- Dokumentacionin financiar mandat arketime dhe listen e personave qe kane kontribuar me fonde per llogari te Partisë për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë, gjate vitit financiar 2018, pra justifikimin shkresor te cdo hyrje ne llogarine bankare ose arken e Subjektit Partia për Europianizimin dhe Integrimin e Shqipërisë.
- Borderot janar - dhjetor 2018 dhe pagesat e kontributeve sipas periudhave.
- Dokumentacionin financiar te shpenzimeve per vitin financiar 2018, fatura blerje, pagesa, kupona tatimor, dhe çdo dokument mbi bazën e të cilave subjekti ka hartuar pasqyrat financiare.
- Raportet e auditimit vjetor të vitit financiar 2017, dhe nëse ka letër drejtimi ose rekomandime së bashku me auditimin.

Së bashku me dokumentacionin financiar Ne duhet të hartojme plotësojmë dhe firmosim një pyetsor mbi:

1. Emrin e Partisë me ndryshimet ligjore gjatë vitit financiar 2018 ose edhe me përpara në rast se këto ndryshime nuk jan evidentuar në Kqz dhe institucionet shtetërore
2. Planifikimin e kohës (nga ana Juaj) kur mund të fillojmë dhe mbarojmë auditimin gjithmone brenda 30 ditëve ne dispozion të realizimit të misionit
3. Zyra ose ambienti ku mund të bëhet kontrolli i dokumentacionit
4. Personi përfaqësues i partisë që do vërë në dispozicion të ekspertit evidencën e auditimit

**Eftali Qirjaqi**
*AUDITUES LIGJOR*
Licensë Nr. 11 Datë 11.01.2000,NIPT K46526078L,
Lagje "Qemal Stafa", Rr. "Studenti", Shkodër
Mobile:+355692069434, +355692079434
Email : eliqirjaqi@yahoo.com

5. Kur mund të fillojmë auditimin në vartësi të evidencës së siguruar nga Ju për auditimin
6. Kur merret evidenca e auditimit pra data e marrjes së evidencës
7. Personat përgjegjës për kontabilitetin, donacionet, arkën
8. Sa llogari bankare ka partia politike.
9. Burimet e financimit me vlera dhe përqindje në krahasim me totalin e të ardhurave të deklaruara.
10. A ka pas të ardhura monetare në cash dhe mënyra si janë regjistruar.
11. A është plotësuar deklarata e konfliktit të interesit në rastet e dhurimeve
12. A është zbatuar ligji mbi mënyrën e përfitimit të donacioneve
13. A ka donacione që kanë kaluar kufirin dhe donacionet kumulative
14. A janë depozituar të gjitha donacionet në llogari bankare specifike ?
15. A ka donacione në natyrë , çfarë dhe si janë dokumentuar ?
16. A i ka pasqyruar Partia politike të gjithë informacionet që kërkon ligji :
    - Deklaratën e konfliktit të interesit
    - Raportet e auditimit
    - Listën e dhurimeve

Ju lutem bëni te mundur përcaktimin e një orari kohor për paraqitjen e ekspertit në selinë e Partisë në zbatim të nenit 5 pika 5.2 përcaktuar në kontratën e shërbimit lidhur me datë 18.05.2019 me nr. prot 889/1 mes Ekspertes Kontabël Znj. Eftali Qirjaqi dhe KQZ.

Në përfundim të auditimit Ne së bashku me raportin e auditimit ku do shprehim opinionin, parashikojmë Tju lëmë edhe një letër drejtimi ku mund të shprehemi për rekomandimet dhe sugjerimet tona për përmirësimin e punës në të ardhmen nëse është e nevojshme.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetem në pritje të komunikimit te metejshem .

*Shkodër, më datë 18/05/2019*

Eftali Qirjaqi
*Audituese Ligjor*

RR 842 094 460 AA




Vitti e

[redacted]




LAJMËRIM MARRJE NR......................

Ky lajmerim - marrje do te kthehet
ne adresën time si më poshtë:

Plotësohet nga dërguesi
i cili duhet të tregojë drejtimin
e tij të plotë për kthimin
e këtij lajmërimi

Mod P6

Z. Eftale Duraj
Kr.Studenti
L. Qemal Stafa
Shkodër

X: Z. Rivelino Suno
Kryetari i Partisë për Europianizimin
dhe Integrimin e Shqipërisë
Rr. Romana e Pavarësisë, Pallati
Hamel, kati i 3, Tiranë